

Marrëveshja për zbatim (implementim) të projekteve për bashkëpunim teknik

Përmbajtja

Bazat e marrëveshjes

1. Treguesit (indikatorët) dhe objektivat e projektit
2. Kontributi i dhënë nga GIZ
Ofrimi (sigurimi) i ekspertëve
Kostot (shpenzimet) operative dhe administrative
Kontributet tjera
3. Kontributi i dhënë nga Kuvendi
Ofrimi (sigurimi) i ekspertëve dhe personelit ndihmës
Kostot (shpenzimet)
4. Dispozitat tjera
Vlerësimi
Pezullimi i kontributeve dhe përfundimi (shkëputja) e marrëveshjes
Kushtet e marrëveshjes
Përshtatja e marrëveshjes
Forma e shkruar
Marrëveshjet me organizatat individuale implementuese
Marrëveshjet qeveritare
Hyrja në fuqi, numri i kopjeve

Marrëveshja e implementimit (zbatimit)

në mes të

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Dag – Hammarskjold-Weg 1-5
65760 Eschborn

tash e tutje referuar si “GIZ”

dhe

Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës (Kuvendi)

tash e tutje referuar si Kuvendi

në lidhje me projektin

Reformimi i Sistemeve financiare publike në Kosovë

tash e tutje referuar si “Projekti”

Bazat e marrëveshjes

Paragrafët në vijim do t'i formojnë bazat e marrëveshjes

- Marrëveshja e datës 13 tetor 2004, që ka të bëjë me Bashkëpunimin teknik, që është, në përputhje me Marrëveshjen e arritur nga shkëmbimi i njoftimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, të 10 qershorit 2011, të zbatohet (aplikohet) ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Bashkëpunim teknik 2014, e datës 8 shkurt 2016 (shih shtojcën 1)
- Proces verbalet e dakorduara për Vlerësimin dhe Shqyrtimin e Masës pasuese (vijuese) të Projektit për Reformim të Sistemeve të financave publike në Kosovë. Rezultatet e Vlerësimit dhe Misioni i vlerësimit të programit, datuar më 26 mars 2015 (shih shtojcën 2)

1. Treguesit (indikatorët) dhe objektivat e projektit

Objektivi i këtij projekti është forcimi i sistemit të financave publike në lidhje me përgjegjësitë dhe efektshmërinë (efikasitetin).

Fushat e intervenimit/rezultatet

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike t'i përmbushin mandatet e tyre më fuqishëm;
2. Informatat gjithëpërfshirëse për planin buxhetor, me theks te posaçëm tek çështjet gjinore dhe grupet e nën përfaqësuar dhe ekzekutimi i tyre janë në dispozicion për Kuvendin dhe qytetarët e tij;
3. Parakushtet për aplikim të njëtrajtshëm dhe të bazuara në rregullat e ligjeve për tatime janë krijuar.

Treguesit (indikatorët):

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF) i rishikon (shqyrton) kapitujt individual të buxhetit, që korrespondon me një vëllim prej 50% të shpenzimeve të buxhetit përkatës.
2. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP) i shqyrton thellësisht 50% të të gjeturave të auditimit të bërë nga Zyra e Auditorit Gjeneral (veçanërisht ato që kanë të bëjnë me auditimet që lidhen me rregullsitë dhe efektshmërinë).
3. 75% e 20 anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike (11 anëtarë të KBF-së ; 9 anëtarë të KMFP-së) konfirmojnë që informata sa më e plot apo gjithëpërfshirëse (veçanërisht pjesa narrative e planit të buxhetit që lidhet me ministrinë e linjës, apo përgjigjet në rekomandimet e KMFP-së) kanë çuar në përmirësimin e shqyrtimeve të politikës financiare, respektivisht në përmirësimin e kontrollit financiar.
4. Numri i vendimeve për gjoba, ndaj të cilave janë bërë ankesa, krahasuar me numrin e gjobave të shqiptuara, është zvogëluar për 2 pikë % në 3.5%.

GIZ-i dhe Kuvendi bashkërisht janë të përkushtuar në këtë objektiv.

2. Kontributet e dhëna për projektin nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përmes GIZ-it

Në përputhje me Marrëveshjen e datës 08.02.2016, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë do t'ia siguroj GIZ-it 2 000 000 Euro (me fjalë dy milion euro) për kontributin gjerman. Kjo shumë do të përfshijë kostot (shpenzimet) e bëra nga Organizata implementuese gjermane.

Sigurimi (ofrimi) i ekspertëve

për këtë projekt, GIZ-i do ta vë në dispozicion

- ekspertin e dytë ndërkombëtarë, i cili do të jetë përgjegjës për dhënien e kontributit nga GIZ-i, dhe i cili, në të njëjtën kohë, do të jetë edhe udhëheqës i ekipit të ekspertëve, të cilët janë vënë në dispozicion për këtë projekt, për kohëzgjatjen e përshkruar në klauzolën 4, të paraqitur më poshtë,
- ekspertët në vijim:
 - a. deri në 2 këshilltar ndërkombëtarë për një periudhë të përgjithshme deri në 30 muaj ekspertizë;
 - b. deri në 6 këshilltarë vendor për një periudhë të përgjithshme deri në 30 muaj ekspertizë;
 - c. ekspertë të tjerë afatshkurtër nëse/ ashtu siç nevojitet me aprovim paraprak të GIZ-it.

Kostot (shpenzimet) operative dhe administrativet

GIZ do t'i bartë kostot (shpenzimet) operative dhe administrative që lidhen me procedimin e kontributit gjerman dhënë për këtë projekt.

Kontributet tjera

GIZ-i do ta mbështesë organizimin dhe lehtësimin e trajnimeve/punëtorive në përputhje me planet e punës së Kuvendit dhe të Agjencive tjera implementuese (Ministrinë e Financave të Kosovës, Administratën Tatimore të Kosovës).

3. Kontributi i Kuvendit

Sigurimi i ekspertëve dhe personelit ndihmës

Kuvendi do ta

-sigurojë përkushtimin për arritjen (përmbushjen) e objektivave.

Kostot (shpenzimet)

Kuvendi duhet të sigurojë që kostot (shpenzimet) e specifikuar në planin e operimit (veprimin) janë buxhetuar në kohën e duhur.

4. Dispozitat tjera

Vlerësimi

GIZ mund ta inicioj (bëjë) një vlerësim të projektit gjatë apo pas zbatimit të kësaj Marrëveshje. Për këtë, GIZ do t'i vlerësoj ekspertët e projektit. Kuvendi do të marrë pjesë në procesin e vlerësimit. Në të gjitha rastet do të asistoj në punën dhe vlerësimin e ekspertëve, dhe do t'ua lejoj atyre ekzaminimin (kontrollimin) e të gjitha dokumenteve të nevojshme.

Kuvendi, me anë të një raporti, do të informohet për rezultatet e vlerësimit.

Pezullimi i kontributeve dhe shkëputja (përfundimi) i Marrëveshjes

GIZ-i mund t'i pezull kontributet nëse

- Kuvendi dështon në përmbushjen e obligimeve që dalin nga kjo Marrëveshje apo ato që dalin nga marrëveshjet që lidhen me këtë Marrëveshje, apo
- Paraqitjen e rrethanave të cilat e përjashtojnë, apo e vënë në rrezik të konsiderueshëm, objektivin e projektit të përshkruar në klauzolën 1 të mësipërme.

Nëse njëra nga rrethanat e përshkruara në fjalinë 1 të mësipërme paraqiten (lindin) dhe akoma vazhdon të ekzistoj pas afatit kohor të dakorduar (rënë dakord) nga GIZ-i dhe Kuvendi, apo nëse nuk eliminohet brenda kësaj periudhe, GIZ-i mundet, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, ta përfundoj para kohës zbatimin (implementimin) e kësaj Marrëveshje.

Afati i Marrëveshjes

Me përjashtim të asaj që parashikohet në klauzolën 4 të mësipërme, për pezullimin e kontributeve dhe përfundimin e marrëveshjes, Marrëveshja do të jetë valide (e vlefshme) për kohëzgjatjen e fazës së vazhdueshme të projektit (aktualisht është caktuar për një periudhë prej 01.01.2016 deri më 30.06.2018). Afati i kësaj marrëveshje mund të zgjatet, në rast se ndodhin vonesat në ekzekutimin e kontributeve gjermane, ashtu siç është përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe në ekzekutimin e kontributeve të dakorduara (të rëna dakord) të Kuvendit.

Përshtatja e Marrëveshjes

Në rast se dispozitat e kësaj Marrëveshje nuk e shpjen përpara përmbushjen efikase të objektivit të cekur në Klauzolën 1 të mësipërme, atëherë GIZ-i dhe Kuvendi mund t'i përshtatin apo ndryshojnë këto dispozita, me pëlqim të dyanshëm, në cilëndo fazë, gjatë zbatimit (implementimit) të projektit. Çdo ndryshim duhet të bëhet me shkrim.

GIZ-i mund ta shkëpus (përfundoj) këtë Marrëveshje në mënyrë të një anshme, në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë ia tërheqë mandatin të cilin ia ka dhënë asaj..

Forma e shkruar

Ndryshimet dhe shtojcat e kësaj Marrëveshje, si dhe çdo deklaratë apo komunikim tjetër i rëndësishëm për ekzekutimin e Marrëveshjes, duhet të bëhet me shkrim. Në rastin e

deklaratave dhe të komunikimit të GIZ-it, do të mjaftojë për ta që të pranohen nga udhëheqësi i ekipit të ekspertëve të ofruar.

Marrëveshjet me organizatat individuale implementuese

Personi përgjegjës për dhënien e kontributit nga GIZ dhe personi/at përgjegjës për dhënien e kontributeve të organizatës partnere apo të organizatave tjera implementuese, së bashku mund të lidhin një marrëveshje detyruese për detajet shtesë, që lidhen me ekzekutimin e këtij projekti (p.sh. në bazë të një plani të veprimit), apo në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme, mund t'i përcaktojnë ato detaje me shkrim, dhe, kur është e nevojshme, ta rregullojnë marrëveshjen e tillë, duke marrë parasysh zhvillimet në projekt.

Marrëveshjet qeveritare

Si në pjesën tjetër, dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (kur është e përshtatshme, Bashkëpunimi Teknik dhe Ekonomik, dhe Marrëveshja për Bashkëpunim Teknik 2014 në mes të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për angazhimet që kanë të bëjnë ne Bashkëpunimin Teknik (shih shtojcën 1)), të dyja këto të përmendura në fillim të kësaj Marrëveshjeje, do të zbatohen edhe për këtë Marrëveshje.

Hyrja në fuqi, numri i kopjeve

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, në datën kur do të nënshkruhet nga të dyja palët nënshkruese. Do të hartohet në dy kopje origjinale.

Prishtinë

Prishtinë

**Deutsche Gesellschaft für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**

**Administrata e Kuvendit të
Republikës së Kosovës**

Z. James Macbeth
Drejtor i GIZ-it

Z. Kadri Veseli
Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Znj. Kadri Jogiste
Udhëheqëse e projektit